



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 22.19.1-2017-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SE**  
**KAÇANIKUT**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, qershor 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Enver Ramadani Udhëheqës i Ekipit të Auditimit, dhe Fetah Osmani e Hysen Restelica - Anëtarë, nën menaxhimin e Mujë Gashit Udhëheqës i Departamentit të Auditimit.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	20
5 Qeverisja e mirë.....	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	24
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	27
Shtojca III: Letër konfirmimi .....	35

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të komunës së Kaçanikut për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 06/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komunës, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

#### **Theksimi i çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuria kapitale në vlerë 350,000€, nuk ishte shpalosur në pasqyrat financiare vjetore.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Kaçanikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është i pavarur nga Komuna dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

---

## **Theksimi i çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin, se shpalesjet e pasurive kapitale në pasqyrat financiare vjetore nuk ishin plotësisht të sakta, për shkak të mos përfshirjes së investimeve kapitale në vlerë 350,000€, për ndërtimin e objektit të QKMF-së në bashkëfinancim me Caritas Luksemburg dhe Ministrin e Shëndetësisë. Kjo ka ardhur për faktin se Komuna nuk kishte marrë dokumentacion mbështetës nga bashkëfinancuesit, për pjesën që ata e kishin financuar. Kjo reflekton pasaktësi në regjistrat e pasurisë dhe shpalesje jo të saktë tyre në PFV-të e vitit 2017.

Opinioni jonë nuk është modifikuar për këtë çështje.

## **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV**

Kryetari i Komunës së Kaçanikut është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigorisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalesjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.



---

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve.
- Nëse PFV janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar ne MF;
- Nëse Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar me kohë;
- Harmonizimet tremujore të shpenzimeve dhe te hyrave me Thesarin;
- Raportin e kontratave të nënshkruara të prokurimit; dhe
- Nëse komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe një kopje tek MF.

PVF-të janë përgatitur në pajtueshmëri me formatin për raportim, si dhe janë nënshkruar dhe dorëzuar brenda afatit ligjor në MF.

Komuna Kaçanikut kishte korrigjuar PFV-të duke përmirësuar raportimin e tyre, megjithatë edhe pas korrigjimit, shpalosja e vlerës së pasurisë nuk është e plotë dhe e saktë (e theksuar të opinionit të auditimit).

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

**Rekomandimi 1** Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, si dhe të merren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar regjistrimin e plotë të pasurisë kapitale. E gjithë pasuria, përfshirë pronat të cilat i posedojnë si dhe pasuritë jo financiare të blera/ndërtuara duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë.

Gjithashtu, Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi i projekteve kapitale vazhdon të mbetet fusha më shqetësuese, duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para si dhe në vonesa në përfundim të projekteve. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, veçanërisht rreth rregullsisë në menaxhimin e tyre. Gjithashtu kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të siguruar rregullsinë në menaxhimin e shpenzimeve.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit për investime kapitale, procesi i prokurimit rreth menaxhimit të kontratave, pasurisë dhe llogarive të arkëtueshme.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>7,039,281</b>	<b>7,197,552</b>	<b>6,713,314</b>	<b>6,651,210</b>	<b>6,942,159</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	6,178,267	6,139,799	6,119,686	6,004,938	6,363,848
Të bartura nga viti paraprak <sup>2</sup> -	0	141,463	111,877	139,523	143,851
Të hyrat vetjake <sup>3</sup>	861,014	861,014	429,036	494,561	421,703
Donacionet e brendshme	0	161	0	6,788	9,040
Donacionet e jashtme	0	55,115	52,715	5,400	3,717

<sup>1</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

<sup>2</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>3</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 158,271€. Fillimisht buxheti ishte rritur për 196,739€ nga donacionet e brendshme dhe të jashtme si dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak, ndërsa më pas më vendim të qeverisë është reduktuar për 38,468€.

Në vitin 2017, Komuna ka shpenzuar 93% të buxhetit final, 4% më pak krahasuar me vitin 2016. Edhe pse, komuna ka një zvogëlim të realizimit të buxhetit, prapëseprapë mbetet në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>7,039,281</b>	<b>7,197,552</b>	<b>6,713,314</b>	<b>6,651,210</b>	<b>6,942,159</b>
Pagat dhe Mëditjet	4,831,215	4,792,747	4,764,649	4,811,836	4,711,887
Mallrat dhe Shërbimet	539,350	562,968	491,378	504,543	453,387
Shërbimet komunale	139,000	141,517	117,200	116,053	123,890
Subvencionet dhe Transferet	204,690	205,710	161,228	204,270	266,721
Investimet Kapitale	1,325,026	1,494,610	1,178,859	1,014,508	1,386,274

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit në vlerë prej 169,584€, vetëm 79% e buxhetit ishte shpenzuar. Rritja e buxhetit ishte nga të hyrat bartura vetjake në vlerë prej 117,846€ dhe donacioneve në vlerë prej 51,738€;
- Zvogëlimi e buxhetit për paga dhe mëditje për 38,468€ është rezultat i kthimit të mjeteve të pashfrytëzuara, për shkak se me buxhet kishin të lejuar 798 punëtor kurse numri aktual i tyre ishte 779;
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime, ishte nga të hyrat e bartura në vlerë prej 20,238€ dhe nga donacionet në vlerën prej 3,380€;
- Rritja e buxhetit për shpenzimet komunale, ishte nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar në vlerë prej 2,517€; si dhe
- Rritja e buxhetit për subvencione dhe transfere, ishte nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar në vlerë prej 1,020€

## Çështja 2 – Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale

- E gjetura** Komuna nuk kishte arritur të realizoj buxhetin për investime kapitale sipas planit dhe projekteve të synuara. Nga projektet të parapara me Programin për Investime Publike, 17 prej tyre në vlerë 97,000€, nuk kishin filluar së zbatuari. Kjo ka shkaktuar një ulje të performancës ndaj shpenzimeve në total. Gjithashtu shkaktarë të ekzekutimit të ulët janë edhe vonesat në realizim të kontratave, që ndërlidhet kryesisht me dinamikën e realizimit të projekteve nga operatorët ekonomik.
- Rreziku** Realizimi i ulët i buxhetit redukton efektivitetin e planeve vjetore të organizatës. Mos-përmbushja e programit për investime kapitale do të rezultojë në realizimin e më pak projekteve, e kjo do të ndikoj në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të siguroj se është ndërmarr një vlerësim sistematik të shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.

## 3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Kaçanikut në 2017 ishin në vlerë 608,215€. Pjesa më e madhe e tyre, në vlerë 233,125€ apo 38%, kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë. Komuna mbledh edhe lloje tjera të hyrave si ato për leje të ndërtimit, të hyra nga shitja e pasurisë-shpronësimi, të hyrat nga veprimtaritë e bizneseve, të hyrat nga qiraja dhe taksat administrative etj.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	861,014	861,014	608,215 <sup>4</sup>	557,285	556,372
<b>Totali</b>	<b>861,014</b>	<b>861,014</b>	<b>608,215</b>	<b>557,285</b>	<b>556,372</b>

Për sa i përket të hyrave vetjake, mund të shihet se përqindja e realizimit është 71% e buxhetit, 8% më pak në krahasim vitin 2016 (në vitin 2016 ishte 79%). Të hyrat vetjake janë shfrytëzuar për shpenzime kapitale 67%, mallra dhe shërbime 11%, subvencionet dhe transferet 21% dhe shpenzimet komunale 1%.

<sup>4</sup> Në këtë vlerë nuk janë përfshirë edhe të hyrat indirekte.

---

### Çështja 3 - Verifikimi i pronave të regjistruara

- E gjetura** Komuna nuk kishte arritur të kryej ri-anketimin për verifikimin e 1/3 e pronave të regjistruara, siç kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Nga 8,847 prona të regjistruara vetëm 1,535 prona janë verifikuar. Komuna nuk kishte arritur të plotësoj këtë kërkesë ligjore (bazën me të dhëna të nevojshme), si pasojë e mungesës të zyrtarëve anketues në terren për grumbullimin e informatave.
- Rreziku** Verifikimi jo i plotë i pronave rrit rrezikun që informacioni aktual të mos jetë i saktë rreth data bazës së tatimit në pronë. Kjo mund të ndikoj negativisht në vlerësimin dhe faturimin e tatimit në pronë.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit të pronave dhe të siguroj se verifikimi i 1/3-ës së tyre bëhet në baza të rregullta vjetore, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara. Rritja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.

### Çështja 4 - Nivel i ulët i inkasimit të të hyrave nga qiradhënia e pronave publike

- E gjetura** Komuna ka dhënë me qira pronat komunale për shfrytëzim të përkohshëm, mirëpo niveli i inkasimit të tyre ishte shumë i ulët. Nga të hyrat e planifikuara nga shfrytëzimi i pronës publike në shumë prej 30,000€, ishin inkasuar vetëm 16,159€ apo 54%. Nga testimi i pesë shfrytëzuesëve, kemi gjetur se komuna kishte vazhduar kontratat me qiramarrësit e pronës publike, edhe pse qiramarrësit nuk kishin kryer obligimet paraprake në shumë prej 24,899€.
- Komuna mbanë evidencë për pronat e dhëna me qira, mirëpo ato nuk janë të plota për të siguruar se të gjitha vlerat janë të llogaritura saktë dhe drejtë. Kësaj evidencë i mungonin informatat për saldon e bartur të borxhit nga viti paraprak si dhe informatat për datën e kontraktuar, përfshirë këtu edhe periudhën e shfrytëzimit të pronës komunale.
- Rreziku** Vazhdimi i kontratave ndaj qiramarrësve pa i kryer obligimet paraprake rritë rrezikun e mos inkasimit të të hyrave, si dhe mungesa e monitorimit ndaj shfrytëzuesve të hapësirave publike rritë rrezikun që komuna të ketë humbje financiare. Po ashtu, mos mbajtja e evidencës me informata të plota bën që menaxhmenti të mos ketë informata për vlefshmërinë e kontratave dhe obligimet e qiramarrësve.

**Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një rishikim i dosjeve të qiramarrësve, kryesisht me qiramarrësit me të cilëve ju kanë vazhduar kontratat pa i kryer obligimet paraprake, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha obligimet e prapambetura. Gjithashtu, të krijoj dhe mbaj një evidencë të qartë dhe të kompletoj atë me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që menaxhimi i të hyrave nga qiraja të jetë më efikas.

#### Çështja 5 - Të hyrat nga lejet e ndërtimit

**E gjetura** Në bazë të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 21, pika 3, është paraparë që aplikuesit i lëshohet leja ndërtimore nëse ka paraqitur dëshmi për pagesën e taksës së lejes ndërtimore. Gjatë testimeve, ne kemi identifikuar se aplikuesit për leje të ndërtimit me nr. të protokollit: 06-352-7875/17 ju ka mundur pagesa me dy këste, me anë të një vendimi të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit në Komunë. Pas pagesës së kështit të I-re i njëjti ka marrë vendimin e lejes të ndërtimit, derisa kishte mbetur obligim për kështin e II-të në vlerë 3,904€.

**Rreziku** Lëshimi i vendimit për leje ndërtimit pa paguar në tërësi taksën paraqet rrezik të mos inkasimit me kohë të të hyrave bazuar në lejet e lëshuara të ndërtimit.

**Rekomandimi 5** Kryetari duhet të ndërmarrë veprime për ta rishikuar vendimin për mundësinë e pagesave me këste, dhe të sigurojë se lejet e ndërtimit lëshohen vetëm pas përfundimit të pagesave të taksave në përputhje me legjislacionin për ndërtimet.

### 3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MF. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë më: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqesin në mes të formularëve; rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin më thesar.

Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 4,831,215€ ndërsa shpenzimet ishin 4,792,747€, apo shprehur në përqindje mbi 99% e buxhetit.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 704,485€. Prej tyre ishin shpenzuar 608,578€ apo 86% të buxhetit final. Kryesisht ato kanë të bëjnë me shpenzimet për shërbimet komunale 117,200€ apo 19%, dhe aktivitete operative që ndërlidhen me shpenzimet, siç janë: furnizimi për zyrë 39,907€ (6.6%), furnizimi më dru 64,138€ (11%), mirëmbajtja auto rrugëve lokale 74,245€ (12%) etj.

#### Çështja 6 – Mungesa e menaxherit të kontratës dhe personave të autorizuar

- E gjetura** Komuna nuk ka arritur të zbatoj udhëzimet e prokurimit për shkak të mungesës së mbikëqyrjes efektive menaxheriale. Autoriteti Kontraktues në kontratën bazë nr. 16 -7045/2016, tek pjesa e III e kontratës – kushtet e veçanta për furnizim me karburante për vetura, nuk ka caktuar menaxher të kontratës dhe persona të autorizuar për pranimin e furnizimeve.
- Rreziku** Mungesa e menaxherit të kontratës dhe e listës së personave të autorizuar për pranim të furnizimit me karburante mund të ketë rrezik lidhur me zbatimin e kushteve të kontraktuara gjatë furnizimit me karburante.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të siguroj se për secilën kontratë të nënshkruar, duhet të ekzistojë menaxheri i kontratës i cili monitoron në vazhdimësi realizimin e kontratës si dhe listën e personave të autorizuar të cilët do të bëjnë pranimin e mallrave dhe shërbimeve të kontraktuara.

#### Çështja 7 – Mos ndalja e tatimit në burim dhe kontributeve pensionale

- E gjetura** Gjatë vitit 2017, Komuna kishte angazhuar punonjës me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta. Në bazë të Ligjit për të ardhurat personale nr. 05-L-028, kërkohet që punëdhënësi të mbajë tatimin në burim, për të ardhurat, përfshirë edhe për të angazhuarit përmes marrëveshjeve të veçanta. Gjatë testimit, të marrëveshjeve për shërbime të veçanta dhe pagesave që kanë rezultuar lidhur me to, kemi vërejtur se komuna nuk kishte mbajtur në burim tatimin dhe kontributin pensional.
- Rreziku** Mos mbajtja në burim e tatimit dhe i kontributeve pensionale paraqet anashkalim të kërkesave ligjore, si dhe rrit rrezikun që Komuna mund të jetë subjekti i ndëshkimeve nga autoritetet përkatëse.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të sigurojë se për secilën pagesë, për të angazhuarit përmes shërbimeve të veçanta, mbanë tatimin në burim dhe kontributet në përputhje me kornizën ligjore për tatimin në të ardhurat e personale.



### 3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 205,710€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 161,228€ apo 78% nga buxheti final. Subvencionet e dhëna kanë të bëjnë me përkrahjen financiare nga ana e komunës për fusha dhe aktivitete të ndryshme.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 1,494,610€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 1,178,859€ apo 79% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me financimin e projekteve kapitale në infrastrukturë, siç janë ndërtimin e objekteve arsimore në vlerë 97,149€, ndërtimin e rrugëve lokale në vlerë 675,549€, pajisjet tjera në shumën prej 85,480€, e të tjera.

#### Rekomandimet.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.7 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

#### Çështja 8 - Mungesa e planit të menaxhimit të kontratave

<b>E gjetura</b>	Në pesë dosje të testuara të tenderëve, kemi vërejtur se komuna nuk kishte përgatitur një plan për menaxhimin e kontratave, kërkesë e Ligjit të Prokurimit Publik e përcaktuar me nenin 88 - Aktivitetet e menaxhimit të Kontratave.
<b>Rreziku</b>	Mungesa e planit të menaxhimit të kontratave rrit rrezikun e mos monitorimit të aktiviteteve të kontraktuara dhe të drejtave tjera të autoritetit kontraktues për tu ushtruar në mënyrë efektive.
<b>Rekomandimi 8</b>	Kryetari duhet të sigurojë se për secilin projekt/kontratë të lidhur paraprakisht të përgatisë një plan për menaxhimin e kontratave dhe të përcaktojë veprimet që do të merren për të siguruar se për secilën kontratë të nënshkruar ekziston plani për menaxhimin e saj.

**Çështja 9 – Pagesa në mungesë të dëshmive të kontrata për sigurimin fizik të objekteve**

- E gjetura** Sipas kontratës për sigurimin fizik të objekteve komunale, njeri ndër kushtet e kontraktuara ishte angazhimi i 13 të punësuarve nga Operatori Ekonomik (OE) dhe paga e tyre mujore të jetë 200€ neto. Gjatë auditimit të pagesës për muajin shkurt 2017, ne nuk kemi vërejtur se pagesa kishte të bashkangjitur dëshmi nga OE lidhur me numrin e punëtoreve të angazhuar dhe shumën e pagesës mujore, referuar në kushtet e kontratës.
- Rreziku** Mungesa e dëshmive të ofruara për kushtet e dala nga kontrata, rritë rrezikun në mos përmbushjen e obligimeve kontraktuale nga ana e OE-së.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të siguroj kontrollë shtesë për të siguruar që pagesat të bëhen në përputhje të plotë me kontratën si dhe kushtet e dhëna në kontratë të mbështetura me dëshmitë e nevojshme.

**3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale**

Gjatë vitit 2017 Komuna ka bërë një progres të dukshëm në aspektin e regjistrimit të pasurive në krahasim me vitin paraprak. Përkundër progresit, ende nuk është arritur që regjistri kontabël i pasurive të jetë plotësisht i saktë. Mos regjistrimi i pasurisë kapitale sipas kategorisë përkatëse është trajtuar tek pjesa e Theksimit të Çështjes në Opinion, ndërsa në këtë pjesë kemi shpalosur dobësitë mbi menaxhimin dhe raportimin e pasurisë më vlerë nën 1,000€.

**Çështja 10 – Evidenca të mangëta për pasuritë më vlerë nën 1,000€**

- E gjetura** Sipas rregullores mbi pasurinë jo financiare<sup>5</sup>, pasuria nën 1,000€ dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin E-pasuria. Komuna, për pasuritë më vlerë nën 1,000€ në PFV ka shpalosur 31,411€. Nga testimi i blerjeve gjatë vitit 2017, kemi identifikuar se nuk ishin të regjistruar pasuritë jo kapitale të blera në vlerë totale 6,581€.
- Me tutje, Komisioni për inventarizimin vjetor të pasurive kapitale dhe jo kapitale nuk kishte bërë barazimin e regjistrave të inventarizimit me regjistra kontabël të mbajtur nga zyrtaret e pasurive.
- Rreziku** Dobësitë e identifikuara në regjistrimin e pasurive jo kapitale, shpijnë në menaxhimin joefikas të këtyre pasurive, nënvlerësimin e tyre dhe paraqitje jo të drejtë në raportimin financiar. Mos harmonizimi i regjistrimit të inventarizimit me regjistrat e pasurisë shkakton mangësi në menaxhimin dhe raportimin e saktë të pasurisë, duke rrezikuar njëkohësisht keqpërdorimin apo humbjen e pasurive.

<sup>5</sup> Neni 6, Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.

**Rekomandimi 10** Kryetari duhet të forcoj kontrollet për siguruar evidentimin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Në këtë aspekt duhet të sigurojë se pas procesit të inventarizimit gjendja e inventarizuar krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme identifikohen dhe më pas pasqyrohen në regjistrat e pasurive.

### 3.9 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të komunës prezantojnë shuma të mjeteve që qytetarët dhe organizatat i detyrohen komunës. Sipas shënimeve të prezantuara në PFV shuma totale e këtyre llogarive në fund të vitit 2017 ishte 1,280,710€, ku prej tyre pjesëmarrja ishte si në vijim: tatimi në pronë në vlerë 1,001,260€; taksat nga veprimtaritë e biznesit në vlerë 203,590€ dhe qiratë nga shfrytëzimi i pronës komunale 75,860€.

#### Çështja 11 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme

**E gjetura** Përkundër rekomandimit të dhënë në vitin paraprak dhe zotimit për zbatimin e tij edhe me tutje komuna nuk ka marrë veprimet e nevojshme për të krijuar mekanizma për të rritur inkasimin e të hyrave të faturuara. Si pasojë të arkëtueshmet edhe me tutje janë shumë të larta, ose në nivel të njëjtë me vitin paraprak. Nga të arkëtueshmet totale, 78% e tyre i takon tatimit në pronë.

**Rreziku** Mungesa e masave konkrete për të inkasuar llogaritë e arkëtueshme vazhdon të rezultojë të nivele të larta të tyre dhe rrjedhimisht edhe me reduktimin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunës. Gjithashtu, kjo redukton edhe fleksibilitetin e komunës ndaj shpenzimeve të planifikuara që financohen nga të hyrat vetjake.

**Rekomandimi 11** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave për inkasimin e të hyrave të saj, përfshirë edhe të arkëtueshmet e mbetura nga vitet paraprake, fillimisht duke i shfrytëzuar të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të komunës, me pas të shfrytëzoj edhe masat tjera ligjore për të siguruar inkasimin e tyre.

### 3.10 Obligimet e papaguara

Sipas PFV-ve, pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 53,345€. Ato janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasura. Komuna ka shpalosur edhe detyrimet kontingjente si konteste gjyqësore, në vlerë 293,500€, më një rritje për 14,050€ në raport me vitin paraprak.

Komuna zbaton një proces relativisht të rregullt të raportimit të obligimeve. Drejtoritë në përgjithësi janë të vetëdijshme për kërkesat e rregullores për raportim të faturave të papaguara si

dhe zyrtari përgjegjës raporton me kohë në Thesar në lidhje me këtë. Megjithatë vlera e obligimeve në raport me vitin paraprak është rritë për 28,645€ ose 46%.

Nga testimet e bëra kemi vërejtur se pjesën me të madhe të obligimeve të mbetura ishin paguar në vitin 2018.

### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të Komunës së Kaçanikut ka rezultuar në 24 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Gjithashtu raporti i auditimit ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, nëntë rekomandime janë zbatuar; pesë ishin në proces dhe dhjetë nuk janë adresuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 13 rekomandime, dhe brenda vitit 2017, dy nga to ishin zbatuar; shtatë rekomandime tjera ishin në proces dhe katër nuk ishin adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

### Çështja 12 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

**E gjetura** Për shkak të menaxhimit të pa mjaftueshëm të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar. Ne nuk kemi vërejtur se Komuna aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve.

**Rreziku** Mos përmirësimet e kërkuara dhe dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve të tjera në sistemet financiarë kyçe, kanë rezultuar në:

- Regjistrat jo të plotë të pasurive kapitale dhe jo kapitale; dhe
- Dobësi të vazhdueshme në shpenzimet përmes prokurimit dhe vlerë të dobët për parandë.

**Rekomandimi 12** Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekzistojnë ende një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunës, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre, por zbatimi i tyre ishte i ulët. Komiteti i auditimit nuk ishte funksional në mungesë të caktimit të kryesuesit. Një ndër elementet kyçe të një qeverisje efektive të komunës është edhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Auditimi i këtij viti ka nxjerrë në pah se niveli i rekomandimeve të zbatuara nga viti i kaluar ishte i ulët, me vetëm nëntë rekomandime të zbatuara nga gjithsej 24 rekomandime të dhëna.

Lista kontrolluese e vet-vlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, duke iu përgjigjur shumicës së pyetjeve me notë mesatare prej 2.10. Sipas pyetësorit të vet-vlerësimit komuna kishte dhënë përgjigje negative në 25 pyetje nga gjithsej 106 sosh. Kjo do të thotë se menaxhmenti duhet të marrë parasysh çështjet të cilat nuk kanë arritur nivelin e pritur.

Komuna ka planin zhvillimor nga viti 2011, por ky plan nuk përfshinë llogaritjen e kostove për matjen e rezultateve të objektivave të saj. Plani zhvillimor i komunës me shumë prezanton statistika se sa trendin e zhvillimit të vet komunës. Përveç një plani emergjent, komuna nuk kishte përgatitur një listë të rreziqeve të cilat janë kërkesë e procedurave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

---

## 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me vetëm një auditor, i cili njëkohësisht është edhe drejtor i njësisë. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja sistematike e një Komiteti efektiv të Auditimit. NJAB gjatë vitit 2017 kishte kryer pesë auditime, katër me rrezikshmëri të lartë dhe një me rrezikshmëri të mesme, ashtu siç ishte më planifikimin vjetor. Si rezultat i këtyre auditimeve janë dhënë 20 rekomandime, prej të cilave një është zbatuar, tetë ishin në proces dhe 11 rekomandime nuk janë zbatuar.

---

### Çështja 13 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NJAB-së dhe komiteti i auditimit

**E gjetura** Menaxhmenti nuk i kishte dhënë rëndësinë e duhur auditimit të brendshëm, ata nuk kishte përgatitë plane të veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe nuk kishin zbatuar rekomandimet e dhëna nga NJAB. Komiteti i auditimit (KA) gjatë vitit 2017 nuk ka mbajte asnjë takim, nga shkakut se kryesuesi i komitetit ka dhënë dorëheqje në fund të muajit maj të vitit 2017 dhe kjo pozitë nuk ishte plotësuar deri në muajin dhjetor të vitit 2017.

Këto rezultate pasqyrojnë mungesën e vëmendjes së Menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm ose për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme.

**Rreziku** Shkalla e ulët e zbatimit rekomandimeve tregon se menaxhmenti nuk i ka dhënë rëndësi të duhur adresimit të tyre. Kjo ndikon në mos adresimin e dobësive në kontrolle dhe përmirësimin e objektivave të organizatës, duke rezultuar me jo efikasitet operativ.

**Rekomandimi 13** Kryetari duhet të siguroj funksionimin e plotë të KA-së, si dhe t'i kushtoj rëndësinë e duhur aktiviteteve të auditimit të brendshëm. Për secilin auditim të bërë nga NJAB-i, duhet të përgatisin planet e veprimit si dhe të monitorojnë ato deri në zbatimin e plotë të rekomandimeve. Po ashtu KA duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë që devijimet e mundshme të adresohen me kohë.

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara ishin të pamjaftueshme dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

### Çështja 14 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

**E gjetura** Si pasojë e kontrolleve të pamjaftueshme menaxheriale, një pjesë e konsiderueshme e buxhetit për investime kapitale dhe mallra e shërbime nuk është shpenzuar. Llogaritë e arkëtueshme nuk ishin trajtuar në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit. Menaxhmenti po ashtu nuk posedon analiza të rregullta periodike për ecuritë buxhetore, nuk rishqyrton planin e prokurimit dhe nuk ka raporte të rregullta të detajuara për aktivitetet operative.

Komuna gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe as që përgatitet ndonjë raport për menaxhimin e tyre.

**Rreziku** Kërkesat e pamjaftueshme të llogaridhënies dhe raportimi i cilësisë jo të duhur reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

**Rekomandimi 14** Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.



---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit nga MF	Kryetari duhet të sigurojë që lista kontrolluese e vetëvlerësimit është plotësuar me objektivet dhe është dokumentuar për të identifikuar dobësitë dhe për ti zvogëluar ato në mënyrë të përshtatshme, siç kërkohet nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës.		Pyetëtori i vet-vlerësimit është përgatitur, nuk ishte bërë hartimi i listës së rreziqeve.	
2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe raportimit të drejtorive komunale për të siguruar angazhime të përmirësuara për të arritur objektivat e veçanta gjatë një viti.		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim, pasi raportimi nuk ishte i plotë për të konstatuar se objektivat janë arritur në kohën e duhur.	
2.5.2 Menaxhimi i riskut	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që procedurat dhe sistemet e menaxhimit të riskut janë krijuar dhe janë funksionale. Për më tepër, përgjegjësia për menaxhimin e riskut është deleguar direkt në një drejtori përkatëse që të sigurojë raportimin mujor mbi zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe të siguroj se risqet duke u menaxhuar.		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim, por mungesa e qasjes së rreziqeve ende ka mbetur te zbatohet në të ardhmen.	
2.5.3 Raportimi Menaxherial	Kryetari i Komunës duhet të rishikojë masat ekzistuese të qeverisjes së përgjithshme dhe cilësinë e raportimit të brendshëm të Komunës. Kërkesat pazbatuara duhet të adresohen deri në fund të vitit 2016. Cilësia e raportimit dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të shqyrtohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar arritjen e objektivave të Komunës.		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim, pasi ka vend që raportimi nga drejtoritë të përmirësohet edhe me tutje.	

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Departamenti i Auditimit të Brendshëm ka burime të përshtatshme dhe të mjaftueshme njerëzore. Për më tepër, Kryetari duhet të sigurojë që aktiviteti i ardhshëm i AB duhet të udhëhiqet në drejtim të zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në risk. Gjithashtu, në mënyrë që përfitimet të jenë të dukshme, Kryetari duhet të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të AB brenda Komunës.		NJAB ka arritur të realizoj planin e saj, mirëpo menaxhmenti nuk ka hartuar plane të veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve ishte shumë i ulët.	
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshme për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat që ato të jenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret përkatës.	Po		
3.5.2 Kompensimet (Pagat dhe Mëditjet)	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi dosjet e personelit në mënyrë që dosjet të jenë të kompletuara dhe organizuara mirë dhe të marrë masa në lidhje me nënshkrimin e listës së pagave.	Po		
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin në kohë dhe të saktë të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës, në përputhje me kërkesat e rregullores 02/2013. Gjithashtu duhet të sigurojë që pasuritë kapitale të cilat regjistrohen përmbajnë informacion të plotë, duke përfshirë datën kur pasuria është vënë në përdorim, në mënyrë që llogaritja e zhvlerësimit të mund të kryhet me saktësi, si dhe të përcaktojë statusin e pronësisë.			Nuk janë marrë masa.
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurive kapitale jo-financiare është kryer në pajtim me Rregulloren në fuqi për pasuritë jo-financiare për të siguruar se inventarizimi bëhet në baza vjetore.		Përkundër përmirësimeve, ende nuk ka harmonizim në mes të regjistrave të inventarizimit më regjistrat e E-pasurisë.	

3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se Komuna është duke bërë përpjekje maksimale për sigurimin e të dhënave nga palët e treta, me theks të veçantë në ato palë që dihet se kanë kryer investime të rëndësishme në komunë. Të dhënat e marra duhet të paraqiten si duhet në regjistrin e pasurive të Komunës. Praktika më e mirë do të kërkojë një barazim vjetor bazë të të dhënave në mes të palëve të treta dhe Komunës për investime në Komunën për vitin përkatës.			Nuk janë marrë masa.
3.7.2 Trajtimi i parasë së gatshme	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollet janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.			Nuk janë marrë masa.
3.7.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari i Komunës duhet të sigurohet se Komuna ndërmerr hapa dhe të hartoj një plan të detajuar lidhur më arkëtimin e borxheve të vjetra.		Komuna ka bërë disa vërejtje me shkrim , mirëpo ende ka vonesa në realizimin e pagesave.	
3.7.4 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm dhe të zhvilloj plane veprimi për të bërë pagesat brenda periudhës së kërkuar.			Nuk janë marrë masa.
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.3 Pasqyrat financiare vjetore	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së Opinionit dhe të merren veprimet e duhura për t'i evituar gabimet në keq klasifikimin e shpenzimeve dhe mos regjistrimin e saktë të pasurive. Gjithashtu, duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			Nuk janë marrë masa.

2.1 Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Kryetari duhet të sigurojë se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike.			Nuk janë marrë masa.
2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit -	Kryetari duhet të sigurojë se është rishikuar plotësisht i listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Ne do të sugjerim që lista kontrolluese të mos i dorëzohet MF-së para se të rishikohet nga auditimi i brendshëm.			Nuk janë marrë masa.
2.3.1 Planet strategjike	Kryetari duhet hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes. Të siguroj se do të përgatitet edhe plani kundër korrupsionit i cili do të zbatohet sipas kërkesave, dhe si i tillë do të bëhet funksional për një qeverisje më efektive.			Nuk janë marrë masa.
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2017		Ekzistojnë raportimet mbi kontrollet menaxheriale sidomos ato financiare, mirëpo duhet të azhurnohen raportet mbi progresin fizik dhe operativ duke synuar që ato operacione të menaxhohen në mënyrë sistematike.	

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të siguroj ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për respektimin e udhëzimeve ligjore, lidhur me organizimin e përbërjes së strukturës organizative të NJAB, respektivisht fuqizimin e rolit të shërbimeve të auditimit të brendshëm. Gjithashtu, të siguroj zbatimin e rekomandimeve të NJAB nga drejtoritë përgjegjëse të sistemeve të audituara, si dhe Komiteti i auditimit të hartoj raportin vjetor në harmoni me Udhëzimin Administrativ 11/2010.		Kryesuesi i Komitetit të auditimit ishte zgjedhur në periudhën e fundit të vitit 2017 por nuk kishte zhvilluar ndonjë aktivitet në lidhje me rekomandimet e NJAB-së.	
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të siguroj dhe të përcaktoj objektiva të qarta për përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në periudhat e ardhshme, dhe të vendosë një monitorim sistematik mbi ekzekutimin e buxhetit të planifikuar, sidomos për projektet kapitale.		Ende është realizimi i ulet i buxhetit sidomos te mallrat e shërbimet dhe investimet kapitale	
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të vendos kontrole mbi verifikimin e pronave, ndryshimet të përcillen në kohë dhe ngarkesat për tatimpaguesit të jenë të sakta, me qëllim të realizimit korrekt të tatimit në pronë.		Plani për ri anketim dhe verifikim është hartuar dhe ka filluar të zbatohet me fillim të vitit fiskal 2017. Sipas planit është paraparë që të verifikohen gjithsej 2949 prona për vitin 2017. Realizimi deri në fund të vitit 2017 ka arritur të bëjë verifikimin e 1535 pronave apo 52% nga planifikimi.	
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se shërbimi i urbanizmit do t'i shqyrtoj të gjitha kërkesat, vetëm pasi të njëjtat të jenë të kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse të cilat kërkohen për një leje ndërtimi si dhe të siguroj se komisioni për shqyrtimin e kërkesave do të zbatoj afatin prej 30 ditësh nga pranimi i kërkesës, në mënyrë që shërbimet të jenë të shpejta dhe të sakta ndaj qytetarit.		Kanë filluar të respektohet afati për shqyrtimin e kërkesave për lëshuarjen e lejeve te ndërtimit por ende ka vonesa si rezultat i problemit te pronës shoqërore brenda qytetit.	

3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se nuk do bëhet vazhdimi i kontratave me qiramarrësit që nuk i kanë kryer obligimet paraprake, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha borxhet e prapambetura. Gjithashtu, të kërkoj nga zyrtari përgjegjës të krijoj një evidencë të qartë dhe të kompletoj atë me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që menaxhimi qirave të jetë më efikas.			Nuk janë marrë masa.
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të siguroj ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për respektimin e procedurave për largimin me kohë nga sistemi i pagave të personave të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës.	Po		
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për respektimin e kërkesave ligjore, lidhur me ri licencimin sipas nevojës të personelit shëndetësor, në pajtueshmëri me Udhëzimin Administrativ përkatës për regjistrimin dhe licencimin e profesionistëve shëndetësor.	Po		
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e projekteve përgatitin për çdo situacion raporte me shkrim duke specifikuar saktë rrugën apo lokacionin ku janë kryer punimet, si dhe të konfirmojnë sasinë dhe cilësinë e punëve. Po ashtu, duhet të siguroj as asnjë shpenzim nuk është çertifikuar pa kontratë përkatëse.	Po		
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj se me rastin e çfarëdo marrëveshje të merret parasysh edhe kosto për shërbime dhe në rast se çmimi i ofruar nuk është i arsyeshëm të kërkoj shërbime nga ndonjë operator tjetër me kosto optimale shërbimi.	Po		



3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për respektimin e kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e brendshme, për sigurimin e kërkesave të mirë arsyetuara nga entitetet përfituese, me rastin e marrjes së vendimit për ndarjen e mjeteve financiare.			Nuk janë marrë masa.
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se paraprakisht janë rishikuar të gjitha paramasat dhe paralogaritë për projekte kapitale në mënyrë që realizimi i projekteve, sa herë që është e mundur, të bëhet vetëm me kontratën bazë.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Mos respektimi i kriterëve të tenderit në këtë rast të sigurimit të tenderit e bën operatorin ekonomik të papërgjegjshëm dhe është mos respektim i LPP-së. Po ashtu, rreziku tjetër është mundësia e tërheqjes së OE para përfundimit të procedurave të prokurimit.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari i komunës duhet të siguroj se zyra e prokurimit do t'i respektoj të gjitha kriteret e tenderimit dhe në rast të shkeljes apo mos zbatimit të kriterëve, të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët përkatësisht nga menaxheri i prokurimit.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari i komunës duhet të siguroj se zyra e prokurimit, përkatësisht komisioni për vlerësim të ofertave do t'i respektoj të gjitha kriteret e dosjes së tenderit si dhe kërkesat tjera ligjore dhe në rast të shkeljes apo mos zbatimit të kriterëve, të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët, përkatësisht nga menaxheri i prokurimit.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të përmirësoj procesin e planifikimit dhe të sigurojë monitorim të këtyre marrëveshjeve që nga inicimi deri në realizimin e plotë të tyre për të parandaluar pagesat për subvencione dhe transfere nga buxheti për investime kapitale.	Po		

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se e-pasuria do të funksionoj në kapacitete të plota, dhe me rastin e planifikimit të buxhetit të merren informata të sakta për pajisjet e amortizuara, në mënyrë që të mundësohet zëvendësimi i tyre në kohën e duhur duke shmangur problemet me aktivitetet operative të komunës.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj	Kryetari duhet të siguroj se një praktikë e tillë do të ndërpritet, dhe të zbatohen kërkesat e rregulloreve financiare që të gjitha shumat e mbledhura në kesh, të depozitohen në bankë brenda afateve ligjore të përcaktuara.			Nuk janë marrë masa.
3.2.3 Te arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj se evidencat për të gjithë tatimpaguesit do të azhurnohen dhe të kompletohen me të gjitha informatat e nevojshme dhe të analizoj shkaqet për inkasim të ulët, si dhe të krijoj mekanizma për rritjen e inkasimit. Po ashtu, të gjej zgjidhje praktike për borxhet e mbetura nga qiramarrësit e lokaleve të rrënuara.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj se ekziston një raportim i drejtë dhe në kohë i të gjitha faturave të papaguara nga të gjitha departamentet, si dhe duhet të siguroj se planifikimi i buxhetit bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkaluar në asnjë rast ndarjet buxhetore.			Nuk janë marrë masa.

## Shtojca III: Letër konfirmimi



Komuna e Kaçanikut

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Kaçanikut , për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Besim Ilazi .....

Kryetar i Komunës,

Data: 30.05.2018, Kaçanik,

